Numër: 01/553
Datë: 07.09.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 07.09.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Riakreditohet** institucioni "ECO - EDUCATION CENTER OXFORD", me dy qendra me adresë: Rr. Gjinollëve, Nr.183, në Komunën e Gjilanit, Republika e Kosovë, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 15.10.2022 deri 14.10.2027, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim:

   1.1 Kurse të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në C1, institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit e aftësimit sipas të dhënave të mëposhtme:

   1.2. Gjilan, qendra **Nr.1**, Rr. Gjinollëve, Nr.183, në Komunën e Gjilanit: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në dymbëdhjetë (12) grupe.

   1.3. Gjilan, qendra **Nr.2**, Rr. Haki Myderezi, Nr.33, në Komunën e Gjilanit: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në dymbëdhjetë (12) grupe.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "ECO - EDUCATION CENTER OXFORD", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, "ECO - EDUCATION CENTER OXFORD", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK